

Tiranë, më 12.02.2019

Lënda: DERGIM SUGJERIMSH LIDHUR ME PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN ZGJEDHOR

**Drejtuar: ZNJ. BLERINA GJYLAMETI DHE Z.OERD BYLYKBASHI
BASHKËKRYETARË TË KOMISIONIT TË POSAÇËM PËR REFORMËN ZGJEDHORE**

Për dijëni: Z.KLEMENT ZGURI, KRYTETAR I KQZ

Të nderuar bashkëkryetarë të Komisionit,

Instituti i Studimeve Politike (ISP) është përpjekur vazhdimisht të ofrojë mbështetjen dhe asistencën përmes rekomandimeve dhe sugjerimeve të ndryshme në seancat dëgjimore të zhvilluara nga Komisioni i Posaçëm të Reformës Zgjedhore. Ne e vlerësojmë ftesën e hapur të Komisionit dhe praktikën e punës gjatë mesit të vitit 2018 për konsultime publike me shoqërinë civile, ku bën pjesë edhe ISP.

Në këtë kuadër, dëshirojmë tju vëmë në dijeni se Instituti i Studimeve Politike është duke kryer monitorimin e shpërdorimit të burimeve shtetërore në funksion të fushatës elektorale, me mbështetjen e Programit të USAID-it në Shqipëri (ACDC-Accelerated Civil Development und Cooperation), si dhe si dhe monitorimin e aktivitetit parlamentar në zbatim të Rregullores, Ligjit mbi Statusin dhe legjislacionit mbi konfliktin e interesit.

Gjatë komunikimeve tona me institucione të ndryshme ekzekutive dhe me KQZ, me parti politike dhe organizata të tjera partnere, kemi konstatuar mungesë të bazës ligjore solide që lidhet me krijimin e instrumenteve që jetësojnë përmbushjen e nenit 9 të Kushtetutës, detyrimin që “burimet financiare të partive, si dhe shpenzimet e tyre bëhen kurdoherë publike” dhe të rekomandimit nr.3 të Misionit të ODIHR/OSBE 2017, sipas të cilit *“qeveria duhet të analizojë efektshmërinë e përpjekjeve të mëparshme për të luftuar shpërdorimin e burimeve shtetërore dhe presionet e lidhura me vendin e punës mbi zgjedhësit. Ajo duhet të marrë në konsideratë ngritjen e një organi transparent, të pavarur dhe përfshirës me detyrën dhe kompetencën e veprimit dhe të ndjekjes në periudhën para dhe pas-zgjedhore. Kjo strukturë mund të ngrihet edhe në nivel vendor në një kohë të mjaftueshme përpara zgjedhjeve të radhës”.*

Gjithashtu kemi konstatuar mungesën e akteve të plota, transparente dhe shteruese të KQZ lidhur me udhëzime mbi praktikën e mira të aktivitetit elektorale të partive politike dhe të institucioneve në drejtim të ndjekjes së standardeve më të larta për parandalimin e përdorimit të burimeve shtetërore në funksion të fushatave elektorale. Fakti që Presidenti ka dekretuar datën e zgjedhjeve në dhjetor 2018, ndërkohë që fushata zyrtarisht kërkon kohë të fillojë, ka krijuar diskordancë midis afatit ligjor të fushatës dhe afatit mbi 6 muaj të përdorimit të mjeteve publike e shtetërore në funksion të fushatës.

ISP ka evidentuar raste të orientimit të investimeve shtetërore e bashkiake në funksion të objektivave elektorale, të përdorimit të simboleve partiake në zyrat shtetërore (KQZ ka adresuar sot shkresë në të gjitha institucionet shtetërore për heqjen e fotos me simbole partiake nga portali shtetëror www.shqipëriageduam.al), ka evidentuar aplikime të praktikës së kontratave të përkohshme në prag të fushatës elektorale apo elementë të tjerë, të cilët mund të përbëjnë cenim të standardeve zgjedhore.

Monitorimi dhe evidencat tona kritike nuk lidhen vetëm me qeverinë qendrore, por edhe me bashkitë Durrës, Kamëz e Vlorë, ku drejtojnë parti dhe koalicione të ndryshme politike.

Ekspertët tanë mendojnë e sugjerojnë që Komisioni i Reformës mund të ndërhyjë me akte direkte (ndryshime në Kodin Zgjedhor ose në Ligjin mbi Partitë Politike), por edhe me dispozita e akte rekomanduese për KQZ për një hapësirë më të madhe veprimi në këtë fushë, në mënyrë që një sërë problematikash emergjente të marrin zgjidhje përpara fillimisht zyrtar të fushatës elektorale.

Konkretisht, ne sugjerojmë dhe rekomandojmë që:

1. Dispozitat që lidhen me nenin 88 të Kodit Zgjedhor apo me legjislacionin e partive politike, për ndalimin e përdorimit të burimeve shtetërore në fushatën elektorale, përfshirë logo, simbole, reklama identifikuese, etj, meritojnë një trajtim më të plotë dhe me shtrirje në kohë nga momenti kur del dekreti i Presidentit të Republikës për datën e zgjedhjeve.
2. Partitë Politike duhet të përfshihen në aplikimin e dënimeve kryesore që parashikon Ligji Nr.9754 datë 14.06.2007 “Për Përgjegjësinë Penale të Personave Juridik”. Ky ligj ka si objekt marrjen në përgjegjësi penale dhe caktimin e masave ndëshkuese (Kryesore dhe Plotësuese) që ushtrohen ndaj subjekteve juridike, krahas atyre me natyrë administrative.
3. ISP propozon gjithashtu amendimin e Nenit 173 të Kodit Zgjedhor, ku krahas sanksioneve për shkelje të rregullave mbi financimin e zgjedhjeve, të cilat ndëshkohen me gjoba në ngarkim të subjekteve politike si dhe ndaj donatorëve e partive politike, duhen parashikuar sanksione të posaçme për çdo titullar, zyrtar apo institucion shtetëror dhe ent publik, i cili në mënyrë të paligjshme është vërtetuar se ka ofruar në kundërshtim më ligjin burimet e tij njerëzore ose materiale në favor të subjekteve të caktuara politike.
4. ISP propozon amendimin e Nenit 92 pika 3 e Kodit Zgjedhor, duke parashikuar në mënyrë eksplicite në këtë dispozitë shmangien e çdo forme të konfliktit të interesit midis audituesit financiar të emëruar nga KQZ dhe subjekteve politike. Mendojmë se kjo dispozitë duhet harmonizuar në referencë edhe me Ligjin Nr. 9367 dt. 07.04.2005, ndryshuar me Ligjin Nr. 9475 dt.09.02.2006, Ligjin 9529 dt. 11.05.2006, Ligji 86/2012 dhe Ligji 44/2014 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”.
5. Së fundi, ISP propozon ndryshimin e Nenit 89 të Kodit Zgjedhor dhe Nenin 23 të Ligjit Për Partitë Politike, duke kërkuar që Partitë Politike të deklarojnë dhe publikojnë çdo fond të dhuruar, duke hequr kufirin prej 100 mijë lekësh të vendosur aktualisht. Mendojmë se kjo do të rritë standardet e transparencës dhe informimit të subjekteve politike karshi publikut.

Me besim në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

Sinqerisht,

Afrim KRASNIQI,
Drejtor Ekzekutiv

